

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

28 janar 2011

**SCEL – 10-0004**

C1/1	[REDACTED]	11250 Železnik	<i>Ankuesit</i>
C1/2	[REDACTED]		
C1/3	[REDACTED], Ferizaj		
C1/4	[REDACTED]		
Të përfaqësuar nga avokati			
C2/1	[REDACTED], fshati Surqinë, Ferizaj		
C2/2	[REDACTED], fshati Greme, Ferizaj		
C2/3	[REDACTED], fshati Rahovicë, Ferizaj		
C2/4	[REDACTED]	Ferizaj/Uroševac	
C2/5	[REDACTED] fshati Prelez i Jerlive, Ferizaj		
C2/6	[REDACTED] Ferizaj		
C2/7	[REDACTED] fshati Pleshinë, Ferizaj		
C2/8	[REDACTED], fshati Varosh, Ferizaj		
C2/9	[REDACTED], Ferizaj		
C2/10	[REDACTED], fshati Nikadim, Ferizaj		
C2/11	[REDACTED], Ferizaj		
C2/12	[REDACTED], Ferizaj		

*kundër*

*E Paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**  
rr. Ilir Konushevci 8, Prishtinë

**Për: Paditësit dhe të Paditurën**

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posacme), Trupi Gjykues i përbërë nga Piero Leanza, Gjyqtar Kryesues, Laura Plesa dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 28 janar 2011, lëshon këtë

**AKTGJYKIM**

1. Ankesat e ushtruara nga C1/1 [REDACTED], C1/2 [REDACTED], C1/3 [REDACTED] dhe C1/4 [REDACTED] refuzohen si të papranueshme.
2. Ankesat e ushtruara nga C2/1 Ajet Llabjani, C2/2 [REDACTED], C2/3 [REDACTED], C2/4 [REDACTED], C2/5 [REDACTED], C2/6 [REDACTED], C2/7 [REDACTED], C2/8 [REDACTED], C2/9 [REDACTED], C2/10 [REDACTED],

C2/11 [REDACTED] dhe C2/12 [REDACTED] pranohen si të bazuara. E Paditura urdhërohet t'i përfshijë këta ankues në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legitime në pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH-së Luboteni, Ferizaj.

**Rrethanat procedurale:**

Më 7 maj 2010, avokati [REDACTED] parashtroi një ankesë pranë Dhomës së Posaçme (Ankesa 1) në emër të ankuesve [REDACTED] (ankuesja C1/1), [REDACTED] (ankuesi C1/2), [REDACTED] (ankuesi C1/3) dhe [REDACTED] (ankuesi C1/4) kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (tani e tutje "AKP").

[REDACTED] (ankuesja C1/1) pohoi se ajo ishte e diskriminuar pasi që ajo nuk është në listën e punëtorëve të ndërmarrjes SHA Urošev grad, Hotel Ljuboten, tani Drita, Hotel Ljuboten, Ferizaj. Ankuesja theksoi se ajo ishte punëtore e ndërmarrjes derisa ajo ishte detyruar te braktiste shtëpinë dhe vendin e saj të punës për shkak të situatës në vitin 1999, gjë që tashmë është e ditur. Ankuesja nënvizoi se Agjencia nuk e ka përfillur procedurën për përpilimin e listës së punëtorëve dhe prandaj ajo është e diskriminuar. Ankuesja ka bashkëngjitur kopjet e vërtetuara të pasaportës së saj, librezës së punës, dhe autorizimit.

[REDACTED] (ankuesi C1/2) pohoi se ai ishte i diskriminuar pasi që ai nuk është në listën e punëtorëve të ndërmarrjes Drita - Urošev grad. Ankuesi theksoi se ai filloi të punojë në ndërmarrje më 6 mars 1997. Gjatë luftës, ankuesi u detyrua ta braktiste punën dhe iku për në Serbi dhe që nga ajo kohë ai nuk ka qenë në gjendje që të kthehet për shkak të situatës në Kosovë e cila tashmë dihet. Ankuesi ka bashkëngjitur kopjet e vërtetuara të autorizimit, librezës së punës dhe të pasaportës së tij.

[REDACTED] (ankuesi C1/3) pohoi se ai ende është i punësuar në ndërmarrjen Hotel Ljuboten - Urošev grad. Ankuesi theksoi se ai filloi të punojë në ndërmarrje më 12 qershor 1995 dhe ai është ende i punësuar atje. Në vitin 1999, ankuesi është dashur ta braktiste shtëpinë e tij dhe të shpërndalej në Mitrovicë dhe që nga atëherë ai nuk ishte në gjendje që të kthehej për shkak të etnititetit të tij serb. Ankuesi ka bashkëngjitur kopjet e vërtetuara të autorizimit, librezën e punës së vërtetuar, dhe vendimin e punës.

[REDACTED] ankuesi C1/4) pohoi se ai ishte i diskriminuar pasi që ai nuk është në listën e punëtorëve të ndërmarrjes Drita - Urošev grad. Ankuesi theksoi se ai filloi të punojë në ndërmarrje më 2 gusht 1993. Gjatë luftës, ankuesi u detyrua ta braktiste punën dhe iku për në Serbi dhe që nga ajo kohë ai nuk ka qenë në gjendje që të kthehet për shkak të situatës në Kosovë e cila tashmë dihet. Ankuesi ka bashkëngjitur kopjet e vërtetuara të autorizimit, të pasaportës së tij dhe vendimit të punës.

AKP-ja, në vërejtjet mes shkrimit të datës 21 maj 2010, theksoi se ankesat C1/1 – C1/4 duhet të refuzohen si të pabaza sepse sipas deklaratave të tyre dhe dëshmive të paraqitura, ankuesit ishin punëtorë të kompanisë Urošev Grad/ Drita Hotel Ljuboten, që nuk është e njëjtë NSH si NSH Luboteni/Fabrika e Tullave.

Përfaqësuesit të ankuesve C1/1 – C1/4 i ishin dërguar vërejtjet me shkrim më 12 qershor 2010 për një përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati i fundit për

parashtrimin e përgjigjes përfundoi më 22 qershori 2010. Asnjë përgjigje nuk është ushtruar deri më sot.

Më 5 maj 2010, ishte parashtruar një ankesë (Ankesa 2) nga ankuesit [REDACTED] (ankuesi C2/1), [REDACTED] (ankuesi C2/2), [REDACTED] (ankuesi C2/3), [REDACTED] (ankuesi C2/4), [REDACTED] (ankuesi C2/5), [REDACTED] (ankuesi C2/6), [REDACTED] (ankuesi C2/7), [REDACTED] (ankuesi C2/8), [REDACTED] (ankuesi C2/9), [REDACTED] (ankuesi C2/10), [REDACTED] (ankuesi C2/11), [REDACTED] (ankuesi C2/12) kundër AKP-së. Ankuesit janë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve të NSH Lubotenit. Ankuesit pohuan se ata tashmë e kanë kundërshtuar listën pranë Dhomës së Posaçme dhe se i kanë dërguar tek gjykata të gjitha dëshmitë. Ankuesit theksuan se janë diku rreth 30-33 punëtorë në këtë fabrikë ndërsa në listën e publikuar janë vetëm 4 punëtor. Ankuesit i kërkuant Dhomës së Posaçme që të ftohen në një seancë dëgjimore, që shpërndarja e 20% të pezullohet, të gjinden dokumentet tanimë të dërguara nga ata tek gjykata dhe të ftohen punëtorët të cilët janë të përfshirë në listë si dhe AKP-ja.

Më 13 maj 2010, AKP-së i ishte dërguar ankesa për vërejtjet me shkrim brenda 7 ditëve në pajtim me nenin 67.8 të Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6. AKP-ja nuk ka parashtruar vërejtje me shkrim.

[REDACTED] (ankuesi C2/1) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej vitit 1975 deri sa masat e përkohshme ishin instaluar në ndërmarrje. Pas viti 1999, ai ishte caktuar drejtor i njësisë Mustafë Goga deri në qershori të viti 2003. Ankuesi theksoi se ndërmarrja ishte komercializuar në vitin 2003 dhe se menaxhmenti i dërgoi të gjithë punëtorët në pushim sepse nuk kishte kushte që të vazhdohej me punë. Paditësi bashkëngjiti këto dokumente: certifikata e regjistrimit për NNZ Mustafë Goga (Fabrika e Tullave), libreza e punës, vendimi i punës 11/01 i datës 11.06.2001 nga NNZ Mustafë Goga, regjistri i të ardhurave personale nga 1989/1990, regjistri i punëtorëve të NNZ Mustafë Goga data e paqartë, vendimet e bordit drejtues të Mustafë Gogës të datës 19.06.01 (Nr. 167/01), 19.06.2001 (Nr. 169/01), 02.08.2001 (209/01), kërkesa nga NNZ Mustafë Goga për dokumentet pronësore të datës 30.10.2001, regjistri i të ardhurave personale për muajin tetor 1999, nëntor 1999, dhjetor 1999, janar 2000, shkurt 2000, mars 2000, prill 2000, maj 2000, qershori 2000, korrik 2000, gusht 2000, shtator 2000, tetor 2000, nëntor 2000, dhjetor 2000, janar 2001, shkurt 2001, mars 2001, prill 2001, korrik 2001, gusht 2001, vendimi i datës 08.11.2001 caktimi i [REDACTED] si drejtor i "Tullores", lista e punëtorëve të Mustafë Gogës e datës 1 prill 2002, njoftimi lidhur orarin e punës, vendimi për dërgimin e punëtorëve të përfshirë në prodhim në pushim për afat të pacaktuar nga data 1.10.2002, regjistri i të ardhurave personale i datës 08.01.02, regjistri i datës 31.12.01, regjistri i shkurtit 2001, dëftesa e pagesës së të ardhurave personale të [REDACTED] për muajin tetor 2002, Lista e xhirologarive tetor 2002, gusht 2002, korrik 2002, 6 raporte nga 2003 në ndërmarrjen Silkapor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershori 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1991. Dëshmia nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar se ankuesi kishte punuar në NSH pas vitit 2001. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershori të vitit 2003. AKP-ja i bashkëngjiti dokumentet pa përkthimin në gjuhën angleze.

Në përgjigjen e datës 16 korrik 2009, ankuesi theksoi se NSH-ja ishte komercializuar në vitin 2001 e deri në vitin 2003. Ai së bashku me 35 punëtorët e tjerë vazhduan të punonin për ndërmarrjen e re Mustafë Goga.

[REDAKTUE] (ankuesi C2/2) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej datës 01.10.1984 deri në vitin 1990 kur të gjithë punëtorët e Kosovës ishin larguar nga puna. Pas vitit 1999, ankuesi ishte lajmëruar në punë dhe pasi që nuk kishte punë drejtori vetëm i regjistronte punëtorët e tillë. Ai theksoi se deri në vitin 1990, fabrika operonte me 35-40 punëtor ndërsa tani vetëm 4 u konsideruan me të drejta legjitme. Ankuesi e kundërshton faktin se punëtorët në listë i plotësojnë kërkesat juridike. Ankuesi bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës, vendimi i punësimit, certifikata e punësimit për periudhën 01.10.1984 – 31.11.1990, protokollit i pranim dorëzimit.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershori 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershori të vitit 2003. AKP-ja bashkëngjiti këto dokumente: libreza e punës e hapur me NSH-në më 01.10.1984 dhe është ende e hapur, dokumente pa përkthimin në gjuhën angleze.

Në përgjigjen e datës 13 korrik 2009, ankuesi nënvízoit se pas vitit 1999 asnjë punëtor nuk ka qenë në listën e pagave sepse Fabrika e Tullave Luboten nuk ishte operacionale. Ankuesi ishte lajmëruar në punë pas vitit 1999, u regjistrua në NSH-në dhe u njoftua nga [REDAKTUE] (C2/1) se punëtorët do të ftohen përsëri në punë. Libreza e tij e punës nuk ishte mbyllur më 31.05.1990 siç thuhet nga AKP-ja.

[REDAKTUE] (ankuesi C2/3) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej datës 21 janar 1988 e deri në masat e përkohshme. Pas vitit 1999, ai filloi të punonte në Mustafë Gogë deri në komercializimin e saj. Më 01.10.2002, menaxhmenti mori vendim t'i dërgonte punëtorët në pushim për afat të pacaktuar. Ankuesi punoi deri në muajin qershori të vitit 2003. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës, vendimi mbi të ardhurat personale, vendimi i punës, kontrata e punësimit e datës 30.04.2002, vendimi për dërgimin e punëtorëve të përfshirë në prodhim në pushim për afat të pacaktuar nga data 1.10.2002.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershori 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 2002. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershori të vitit 2003. AKP-ja i bashkëngjiti dokumentet pa përkthimin në gjuhën angleze.

Vërejtjet me shkrim ishin dërguar tek ankuesi më 11 korrik 2009. Afati i fundit për ankuesin që të parashtrojë një përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim të AKP-së ka kaluar më 21 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është ushtruar.

**[redacted] (ankuesja C2/4)** pohoi se ajo ishte punësuar pranë NSH-së prej 18 janarit 1980 e deri në masat e përkohshme. Pas vitit 1999, ajo filloi të punonte në Mustafë Gogë. Më 01.10.2002, menaxhmenti mori vendim t'i dërgonte punëtorët në pushim për afat të pacaktuar. Ankuesja punoi deri në muajin qershor të vitit 2003 si arkëtare. Ankuesja i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës, 2 vendimet mbi të ardhurat personale, vendimi mbi pushimin vjetor, vendimi mbi rimbursimin.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankueses me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesja nuk ka paraqitur dëshmi se ajo kishte punuar në NSH në vitin 1990 ose 1999. Ajo nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershor të vitit 2003. AKP-ja i bashkëngjiti dokumentet pa përkthimin në gjuhën angleze.

Në përgjigjen e datës 14 korrik 2009, ankuesja ka pohuar se punësimi ishte përfunduar më 31.05.1990 por punëtorët vazhduan të punonin pa pagesë deri më datën 31.12.1990. Punëtorët ishin diskriminuar; fabrika ishte mbyllur për shkak të masave të përkohshme. Ankuesja e mori përsëri librezën a saj të punës në vitin 2007 në mënyrë që të kërkonte punë diku tjetër.

**[redacted] (ankuesi C2/5)** pretendoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej vitit 1972 e deri në vitin 1990 kur ai ishte larguar nga puna nga autoritetet serbe. Ai punoi në NSH në vitin 1999 dhe 2000, por ndërmarrja kishte vështirësi dhe punëtorët është dashur që të ndalojnë së punuari. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës, certifikata e punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1990 dhe 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershor të vitit 2003.

Vërejtjet me shkrim ishin dërguar tek ankuesi më 14 korrik 2009. Afati i fundit për ankuesin që të parashtrojë një përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim të AKP-së ka kaluar më 24 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është ushtruar.

**[redacted] (ankuesi C2/6)** pretendoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej vitit 1987 e deri në vitin 1990 kur ai ishte larguar nga puna nga autoritetet serbe. Pas vitit 1999, ai punoi në NSH në vitet 1999 dhe 2000, por ndërmarrja kishte vështirësi dhe punëtorët është dashur që të ndalojnë së punuari. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershor të vitit 2003.

Vërejtjet me shkrim ishin dërguar tek ankuesi më 11 korrik 2009. Afati i fundit për ankuesin që të parashtrojë një përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim të AKP-së ka kaluar më 21 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është ushtruar.

[redacted] (ankuesi C2/7) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej 18 prillit 1986 deri më 31.05.1990. Ai ishte diskriminuar në vitin 1990 kur së bashku me të gjithë punëtorët shqiptar ishte larguar nga puna me dhunë nga masat e përkohshme. Pas vitit 1999, ankuesi ishte lajmëruar në punë por fabrika ishte shkatërruar. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1990 ose 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershor të vitit 2003.

[redacted] (ankuesi C2/8) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej vitit 1974 deri në masat e përkohshme. Pas vitit 1999, ai ishte punësuar pranë NNZ Mustafë Goga deri në muajin qershor të vitit 2003. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kontrata e punësimit, kopja e vërtetuar e librezës së punës, dëftesat e pagesave përmes muajit gusht 2002, titor 2002 nga Tullorja, kërkesa tek AKM-ja.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë pasi që ankuesi ka arritur moshën e pensionit para datës së privatizimit, më 21 nëntor 2006. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai i përbushë kërkesat juridike që të përfshihet në listë.

[redacted] (ankuesi C2/9) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej muajit maj të vitit 1978 derisa ai ishte larguar nga puna nga autoritetet. Pas vitit 1999, ai ishte lajmëruar në punë, por nuk kishte punë. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1990 ose 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershor të vitit 2003.

Në përgjigjen e datës 15 korrik 2009, ankuesi pohoi se fabrika nuk mund të operonte me 4 rojtarë.

[redacted] (ankuesi C2/10) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej datës 24.04.1971 deri më datën 31.04.1990 kur ai ishte larguar nga puna nga autoritetet serbe në mënyrë të dhunshme, për çka edhe libreza e tij e punës është mbyllur. Pas vitit 1999, ai ishte lajmëruar në punë por ndërmarrja nuk ishte operacionale. Ankuesja i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershor 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990 dhe sipas librezës së punës ankuesi filloi të punojë për një ndërmarrje

tjetër. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershori të vitit 2003.

Vërejtjet me shkrim ishin dërguar tek ankuesi më 10 korrik 2009. Afati i fundit për ankuesin që të parashtrojë një përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim të AKP-së ka kaluar më 20 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është ushtruar.

(ankuesi C2/11) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej datës 24 qershori 1972 deri më datën 31.05.1990 kur ai ishte larguar nga puna në mënyrë të padrejtë nga masat e përkohshme. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës, certifikata e punësimit;

Në vërejtjet me shkrim të datës 22 qershori 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Punësimi i ankuesit me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai kishte punuar në NSH pas vitit 1990 ose 1999. Ai nuk ishte në listën e pagave ose në listën në pritje të NSH-së në kohën e privatizimit. Fabrika ishte mbyllur në qershori të vitit 2003.

(ankuesi C2/12) pohoi se ai ishte punësuar pranë NSH-së prej vitit 1965 deri më 31.05.1990 kur ai ishte larguar nga puna nga masat e përkohshme. Ai ishte lajmëruar në punë pas vitit 1999. Ankuesi i bashkëngjiti këto dokumente: kopja e vërtetuar e librezës së punës, certifikata e punësimit.

Në vërejtjet me shkrim të datës 26 qershori 2009, AKP-ja pohoi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë pasi që punësimi i tij me NSH-në ishte përfunduar më 31.05.1990 dhe ankuesi, i lindur më 17.04.1940, ka arritur moshën e pensionit para datës së privatizimit. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se ai i përmبushë kërkësat juridike që të përfshihet në listë.

Vërejtjet me shkrim ishin dërguar tek ankuesi më 11 korrik 2009. Afati i fundit për ankuesin që të parashtrojë një përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim të AKP-së ka kaluar më 21 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është ushtruar.

Më 8 qershori 2010, AKP-ja pretendoi se me aktvendimin e Dhomës së Posaçme SCEL-09-0011 të datës 17 shtator 2009 i vërtetuar nga aktvendimi i Kolegit të Ankesave ASC-09-0067 i datës 9 mars 2010, AKP-ja ka publikuar një listë të re të punëtorëve të NSH Luboteni në Ferizaj. Ankesat kundër listave të tillë janë të regjistruala në rastin në fjalë. AKP-ja ka bashkëngjitur raportin e Komisionit Shqyrtyes të Padive dhe kopjet e publikimeve të listës së re në media.

Më 17 qershori 2010, AKP-ja sqaroi se lista e punëtorëve të NSH Urošev grad/ Drita Hotel Ljuboten në Ferizaj siç referohet nga ankuesit të regjistruar nën Ankesën 1 tashmë është shqyrtaur në SCEL-06-0021 dhe është vërtetuar nga aktgjykimi i prerë i gjykatës. Të gjitha dokumentet lidhur me këtë NSH janë paraqitur në SCEL-06-0021. AKP-ja më tutje e dorëzoi Kërkësen për Përcaktimin e Statusit dhe Librin e Amzës së Punëtorëve për NSH-në Luboteni.

Me urdhrin e datës 26 korrik 2010, Ankuesve 5,6,7,8,9,10,11,12,13 dhe 15 i janë dërguar Vërejtjet me Shkrim të Komisionit Shqyrtyes (pjesët relevante) të dorëzuara

në Dhomën e Posaçme nga AKP-ja më 8 qershor 2010. Me qëllim të gjykimit të çështjes, shkresat e lëndës SCEL-09-0011 i janë bashkëngjitur SCEL-10-0004.

Më 9 gusht 2010, AKP-ja dorëzoi dëshmi dokumentuese në bazë të cilave e nxirri vendimin për të përfshirë katër punëtorët në listën e publikuar: raporti, regjistri i paraqitjes në punë, librezat e punësimit.

Me urdhrin e datës 18 gusht 2010, AKP-ja u urdhërua që të dorëzojnë në DHPGJS përkthimin në anglisht e të gjitha dëshmive të prezantuara nga AKP-ja me vërejtjet me shkrim për ankesat dhe të plotësohen të gjitha dokumentet e paraqitura nga AKP-ja vetëm në gjuhën angleze me përkthim në gjuhën e ankuesve përfshirë, por të mos kufizohet në Vërejtjet me Shkrim për ankesat e paraqitura nga AKP-ja më 8 qershor 2010.

DHPGJS-ja mbajti seancë të dëgjimit të provave më 25 gusht 2010 me Ankuesit dhe AKP-në. DHPGJS-ja mbajti seancë për dëgjimin e provave më 25 gusht 2010 me Ankuesit dhe AKP-në. Ankuesit C1/1 [REDACTED], C1/2 [REDACTED], C1/3 [REDACTED] dhe C1/4 [REDACTED] të ftuar me kohë nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, avokatit [REDACTED] nuk ishin të pranishëm vet dhe nuk e dërguan përfaqësuesin e tyre. Ankuesit C2/1 [REDACTED], C2/2 [REDACTED], C2/3 [REDACTED], C2/4 [REDACTED], C2/6 [REDACTED], C2/7 [REDACTED], C2/8 [REDACTED], C2/9 [REDACTED], C2/10 [REDACTED], C2/11 [REDACTED] u paraqiten vet. C2/10 [REDACTED] pohoi se ankuesi i fundit C2/12 [REDACTED] kishte ndërruar jetë.

Më 3 shtator 2010, AKP-ja pohoi se kontrata e shitjes për NSH-në e datës 21 nëntor 2006. AKP-ja tha se dëshmitë e bashkëngjitura me vërejtjet e tyre me shkrim për ankesat janë dokument i dorëzuar nga palët në AKP në mbështetje të padive të tyre. Prandaj, duhet që palët të detyrohen të aranzhojnë përkthimin në anglisht të dokumenteve në mbështetje të padive të tyre dhe të mos detyrohet AKP-ja për një gjë të tillë.

Më 10 shtator 2010, AKP-ja e dorëzoi përkthimin në shqip të vërejtjeve me shkrim ndaj ankesave.

#### Arsyet Ligjore:

Ankuesit kërkuan nga Dhoma e Posaçme që të përfshihen në listën e punëtorëve me të drejtë legjitime në pjesën e 20% nga të ardhurat prej shitjes së NSH-së “Luboteni”, Ferizaj, e përgatitur dhe publikuar nga AKP-ja. Të gjithë Ankuesit pohuan se i përbushin kërkuesat ligjore që të përfshihen në listë.

Në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/45 Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore:

*“10.1 10.1 Për shkak të statusit të veçantë të punësuarve në ndërmarrjet në pronësi shoqërore në relacion me këto ndërmarrje dhe ndikimit që privatizimi do të ketë në këtë status, të punësuarit e tillë kanë të drejtë parësore të përfitojnë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Kjo pjesë do të jetë 20% e të ardhurave nga shitja e:*

- (i) aksioneve të një filiali të korporatës së një ndërmarrjeje të privatizuar në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12 ose  
(ii) pasurisë që i nënshtronhet procesit të likuidimit vullnetar në bazë të nenit 9 të Rregullores nr. 2002/12.

*Shuma do të ndahet në dobi të punësuarve me të drejta legitime në përputhje me këtë nen.”*

Në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshim):  
*“Lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legitime e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me paragrafin 10.6, publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe.”*

AKP-ja e publikoi listën e punëtorëve në përputhje me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime) me njoftimin për të drejtën për të ushtruar ankesë në Dhomën e Posacme deri më datën 8 maj 2010. AKP-ja i dorëzoi publikimet në gazetenë në gjuhën serbe “Blic” në datat 14, 15 dhe 17 prill 2010 (e shtunë) dhe në gazetat në gjuhën shqipe “Kosova Sot” dhe “Koha Ditore” në datat 15, 16 dhe 17 prill 2010 (e shtunë).

Procedura për parashtrimin e ankesës në Dhomën e Posacme përcaktohet në nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshim), i cili thotë se: *“Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posacme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legitime. Dhoma e Posacme shqyrton çfarëdo ankesë në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankesa brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre.”*

Afati kohor për ushtrimin e ankesave në Dhomën e Posacme, në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ka skaduar më 8 maj 2010. Dhoma e Posacme i ka regjistruar 16 ankesa të cilat kërkonin përfshirjen në listën përfundimtare të punëtorëve legitim të përpiluar nga AKP-ja. Të gjitha ankesat janë dorëzuar me kohë.

Ankuesit C1/1 [REDACTED], C1/2 [REDACTED], C1/3 [REDACTED] dhe C1/4 [REDACTED] i referohen kompanisë NSH Drita/ DD Urošev Grad/ Hotel Ljuboten në Ferizaj. AKP-ja argumentoi duke thënë se ankesat janë të pabazuara sepse ata janë ish punëtorë të Hotel Kompanisë së quajtur DD Urosev Grad/ Drita Hotel Ljuboten, e cila nuk është ndërmarije e njëjtë si NSH-ja Luboteni/Fabrika e Tullave.

Dhoma e Posacme gjen se Ankuesit C1/1 – C1/4 po kërkojnë përfshirjen në listën e NSH-së Drita në Ferizaj, gjithashtu e referuar si DD Urošev Grad dhe Sutjeska. Lista e punëtorëve të kësaj ndërmarrje u shqyrtua nga Dhoma e Posacme nën numrin SCC-06-0021 dhe është finalizuar nga aktgjykimi përfundimtar i gjykatës më datën 31 janar 2007. Ankesat e C1/1 [REDACTED], C1/2 [REDACTED], C1/3 [REDACTED] dhe C1/4 [REDACTED] do të duhet të ishin ushtruar për këtë lëndë – SCC-06-0021. Lista e NSH-së në të cilën ishin punësuar nuk mund të shqyrtohet edhe njëherë, pasi është vendosur në mënyrë të prerë. Sa i përket të drejtave që i kërkojnë

në lidhje me NSH-në "Luboteni", Ferizaj këto nuk ekzistojnë pasi që të gjitha dëshmitë e dorëzuara nuk vërtetojnë marrëdhënie të punës me atë NSH.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshim) përcakton kërkesat ligjore për punëtorët me të drejtë legjitime: "*Sipas këtij nenit, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilat pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.*"

Në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime) një punëtor do të konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar në NSH në datën e: "*inicimit të procedurës për likuidim*". Më 5 prill 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) parashtroi kërkesë për pezullimin e të gjitha lëndëve që janë në pritje kundër NSH-së Luboteni, Fabrika e Tullave, në Ferizaj. AKM-ja pohoi se likuidimi i NSH-së filloi duke hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2005. Megjithatë, siç u tha nga AKP-ja në vërejtjet me shkrim për ankesat se Fabrika është mbyllur në qershor të vitit 2003. Prandaj, gjykata konsideron se data relevante për të vendosur se cilët punëtor i plotsjnë kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshim nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/45 është 1 qershor 2003. Qëllimi i dispozitave të nenit 10.4 të cituar më lartë është të kompensohen punëtorët për kontributin e tyre – me kohë – në vlerën e aseteve (dhe për humbjen e vendeve të tyre të punës kur kjo ndodhë drejtëpërdrejtë e shkaktuar nga privatizimi). Për NSH-të e mbyllura para likuidimit, ky nen do të ishte jo i aplikueshëm nëse lexohet në kuptimin e tij fjalë përfshirë. Për këtë arsy, Gjykata do të vërtetojë kërkesat e përcaktuara nga nen 10.4 duke e marrë parasysh datën e mbylljes së NSH-së.

Interpretimi tjeter i vlefshëm për të gjithë ankuesit është: se punëtor me të drejtë legjitime është ai i cili punon me NSH-në edhe nëse nuk ka regjistrim të këtyre marrëdhënieve të punës. Dëshmia e marrëdhënieve të punës duhet të bëhet në bazë të rregullës së përgjithshme në këtë lëndë, por jo ekzistanca e regjistrimit nuk e përashton të drejtë përfshirë kërkuar e të hyrave.

Ankuesit C2/1 [REDACTED], C2/2 [REDACTED], C2/3 [REDACTED], C2/4 [REDACTED], C2/5 [REDACTED], C2/6 [REDACTED], C2/7 [REDACTED], C2/8 [REDACTED], C2/9 [REDACTED], C2/10 [REDACTED], C2/11 [REDACTED] dhe C2/12 [REDACTED]

pohuan se ishin larguar nga puna në vitin 1990dhe 1991 sepse janë shqiptarë të Kosovës. Të gjithë ata pohuan se do t'i përbushnin kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK 2003/13 (me ndryshime) nëse nuk do t'i ishin nënshtuar diskriminimit. Prandaj, ata e kanë ushtruar ankesën e tyre në Dhomën e Posaçme në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Në lidhje me dëshminë e kërkuar përfshirë vërtetuar deklaratat përfshirë diskriminimin, nen 10.6 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime) thotë: "*Çfarëdo ankesë e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminimin si shkak përfshirjen në listën e të punësuarve me të drejtë legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara përfshirë diskriminimin e pretenduar.*"

Megjithatë, neni 8.1 i Ligjit kundër diskriminimit 2004/3 thotë si vijon:

*“8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.*

*8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda te tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.”*

Neni 11 i të njëjtit ligj thotë:

*“11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.*

*11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlefjnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji”.*

Ligji kundër diskriminimit 2004/3 u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 30 korrik 2004 dhe u shpall me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32 më 20 gusht 2004. Në pajtim me nenin 13.1 ligji do të hyjë në fuqi 30 ditë pas miratimi të tij nga Kuvendi dhe shpalljes nga PSSP-ja.

Prandaj, neni 8 i ligjit kundër diskriminimit pasi u miratua si rrjedhojë e zëvendëson nenin 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Në pajtim me nenin 8 të ligjit kundër diskriminimit, individët që pretendojnë se janë diskriminuar duhet të dorëzojnë fakte nga të cilat mund të kuptoher se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë. Përveç kësaj, e Paditura do të duhej të adresonte deklaratën për diskriminim dhe të vërtetojë se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë.

Në këtë aspekt, gjykata i bënë këto sqarime: ankuesit duhet të vërtetojnë disa fakte pran Gjykatës. Bazuar mbi ato fakte duhet të nxirret konkludimi për diskriminim. E Paditura duhet ose të hedh poshtë faktet apo konkludimin se faktet paraqesin dëshmi për diskriminim. Ankuesit të cilët pretenduan se janë diskriminuar pohuan se përfaktin që janë të entitetit shqiptar janë larguar nga puna nga regjimi serb.

Gjykata konstatoi se librezat e punës së paditësve 11 dhe 12 – ish punëtor të NSH-së – janë myllur në të njëjtën ditë 31.05.1990 dhe nuk ka dëshmi se masa përiorganizimin e fabrikës e ka kërkuar këtë apo ndonjë shkak tjetër është gjetur ng menaxhimi i ndërmarrjes përlendën e caktuar. Për këtë arsyе gjykata konstatoi se dëshmia e prezantuar mund të shpie në konkludimin se nuk është mbrojtur trajtimi i barabartë i punëtorëve.

Dhoma e Posaqme konstaton se ankuesit i plotësojnë kërkesat e caktuara në nenin 10.4 në lidhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime dhe, prandaj, ankesat e tyre pranohen si të bazuara.

Ekzistojnë dy kategori të ankuesve – ish punëtorët e NSH-së – ata të cilët punuan pasi NSH-ja ka filluar sërisht operimin e saj në vitin 2001 dhe të tjerët të cilën nuk janë

kthyer për të punuar në fabrikë. Gjykata e ka vërtetuar kriterin e listës së pagave për tri vjet për ata të cilët kanë punuar në kohën e mbylljes së fabrikës. Ata të cilët kanë mundur të punojnë poqë se nuk do të ishin diskriminuar duhet të tregojnë se për shkak të masave diskriminuese janë parandaluar që të jenë të regjistruar në kohën e mbylljes së fabrikës. Gjykata vërtetoi kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës për at punëtor të cilët janë diskriminuar pasi që fakti i vërtetuar peshon më shumë se sa konkludimi i palës tjetër të ndërlidhur (sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), ku ankuesi i cili pretendon se është diskriminuar nuk e ka obligim të prezantojë fakte tjera përveç masave diskriminuese; përfundimi i thjeshtë se në situatë jo-diskriminuese ata do të ishin punëtorë me të drejtë legitime do të vihej pastaj nëse nuk paraqitet dëshmi e kundërt me atë).

Ankuesi C2/1 [REDACTED], i lindur më 2 maj 1950, u punësua në NSH nga 3 nëntori 1975 deri më 12 mars 1977, dhe nga 9 marsi 1978 deri më 31 maj 1991. që nga qershori 1999, ai u kthye në punë sipas dëshmisë së kopjes së pagesave për rroga dhe në bazë aktvendimit të datës 8 nëntor 2001, ai u emërua drejtor i Fabrikës së Tullave. Në seancën e shqyrtimit të provave të datës 25 gusht 2010, ankuesi tha se ai u largua nga puna në bazë të diskriminimit dhe pas vitit 1999 ai ishte drejtor i kompanisë. NSH-ja Luboteni ishte njësi në strukturën e NNZ Mustafë Goga, e njohur më herët si Trajko Gergovic. NSH-ja Luboteni është quajtur edhe me emrin Tullorja. Silkapor ishte kompania e përfshirë në komercializimin e NSH-së, duke qenë kompania të cilës i është dhënë me qira IMN Tullorja. Ankuesi dhe gardat punuan deri në qershori të vitit 2003. Sipas raportit nga kompania Silkapor, në lidhje me periudhën 1 qershori 2003 – 13 qershori 2003, për kalkulimin e orëve të punës për IMN Tulloria, ankuesi radhitet nën numrin 5- faqja me numër 46 në mesin e dokumenteve të dorëzuara nga ky ankues. E Paditura kontestoi se ankuesi është punësuar në NSH pas vitit 2001 dhe tha se fabrika është mbyllur në qershori të vitit 2003. Por, sipas dokumenteve të përmendura, Gjykata gjeti se ky pretendim është vërtetuar. Prandaj, Dhoma e Posaçme konstaton se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e pagave për më shumë se tri vite dhe është punësuar në kompani më 1 qershori 2003.

Ankuesi C2/2 [REDACTED], i lindur më 17 qershor 1961, u punësua në NSH nga 01 tetor 1984. Punësimi nuk i është ndërpëre sipas dëshmisë në librezën e punës e prezantuar nga e Paditura. Por, sipas certifikatës së datës 17.09.1999, ai ka qenë në marrëdhënie pune nga 01.10.1984 deri më 31.11.1990. Në seancën e shqyrtimit të provave, ankuesi tha se ai dhe të gjithë punëtorët tjerë të kombësisë shqiptare janë larguar nga puna nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. Ankuesi më tej i kontestoi dy punëtorë në listën e publikuar, [REDACTED] dhe [REDACTED]. E Paditura kontestoi se ankuesi është punësuar pas vitit 1999. E Paditura nuk kundërshtoi deklaratën për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma e Posaçme konstaton se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e rrogave për më shumë se tri vjet, dhe se ka mundur të jetë në listën e rrogave më 1 qershori 2003 nëse nuk do t'i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi C2/3 [REDACTED], i lindur më 8 nëntor 1963 u punësua në NSH nga 21 janari 1988 deri më 31 maj 1990 (2 vjet, 4 muaj, 11 ditë). Ankuesi filloi të punojnë në Tulloria që nga data 1 maj 2002 sipas dëshmisë së kontratës së punësimit të datës 30 prill 2002. Me aktvendimin e datës 30.09.2002, ai u dërgua në pushim pa pagesë “për

periudhë të pacaktuar". Kjo nënkupton se marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë në kohën e mbylljes së NSH-së. Në seancën e shqyrtimit të provave, ankuesi tha se ai është larguar nga puna nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi është punësuar në NSH para 31 majit 1990, por e kontestoi deklaratën se ai u kthye në punë pas vitit 2002. Në bazë të dokumenteve të përmendura më lartë, Gjykata konstatoi se pretendimi i tij në lidhje me marrëdhënien e punës e cila rifilloi në vitin 2002 janë vërtetuar. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e pagave për më shumë se tri vite dhe është punësuar në kompani më 1 qershor 2003.

Ankuesja C2/4 [REDACTED], e lindur më 4 janar 1958, u punësua në NSH nga data 18 janar 1980 deri më 31 maj 1990. Në seancën e shqyrtimit të provave, ankuesja pohoi se ajo është larguar prej punës nga regjimi serb në vitin 1990, pastaj ajo u kthye në punë në vitin 2002 për gjashtë muaj (Sipas raportit nga kompania Tullorja në lidhje me muajin korrik 2002, për kalkulimin e orëve të punës për IMN Tulloria, ankuesja renditet me numrin 18 – faqe me numër 114 në mesin e dokumenteve të dorëzuara nga ankuesja C2/1). Në bazë të fletëpagesës së të ardhurave personale të muajit tetor 2002, ajo ishte punësuar nga NSH-ja në atë kohë dhe nuk ka dëshmi se është marrë vendim për ndërprerjen e marrëdhënieve së punës deri në qershor të vitit 2003. E Paditura nuk ka kundërshtuar se ankuesja është punësuar në NSH para datës 31 maj 1990. E Paditura nuk ka kundërshtuar deklaratën për diskriminimin në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të Paditurës se ankesa është e pabazuar sepse ankuesja nuk është regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, më 21 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e cekura më parë. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesja [REDACTED] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ajo ka qenë në listën e pagave për më shumë se tri vite dhe se ajo do të mund të ishte në listën e pagave më 1 qershor 2003 nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesi C2/5 [REDACTED], i lindur më 28 gusht 1946, është punësuar në NSH nga 4 marsi 1972 deri më 31 maj 1990. Ankuesi pohoi se është larguar nga puna nga autoritetet serbe në vitin 1990. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi është punësuar në NSH para datës 31 maj 1990. E Paditura nuk kundërshtoi se deklarata për diskriminimin në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të Paditurës se ankesa është e pabazë sepse ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, më 21 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e përmendura më lartë. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi Ilmi Hyseni i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e pagave për më shumë se tri vjet dhe se ai do të mund të ishte në listën e pagave më 1 qershor 2003, nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesi C2/6 [REDACTED], i lindur më 3 prill 1968, është punësuar në NSH nga 10 korriku 1987 deri më 10 shtator 1987 (2 muaj), dhe nga 1 shkurti 1988 deri më 31 maj 1990 (2 vjet, 4 muaj). Në seancën e shqyrtimit të provave, ankuesi pohoi se ai është larguar prej punës nga autoritetet serbe për shkak të diskriminimit. Ai tha se ai së bashku me punëtorët tjerë un kthye në punë në vitin 1999, por në vitin 2000 atyre iu deshtë të ndërprenë punën për shkak të vështirësive në fabrikë. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi është punësuar në NSH para datës 31 maj 1990, por e kundërshtoi deklaratën se ai është kthyer në punë pas vitit 1999. AKP-ja nuk e ka

kundërshtuar deklaratën për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Nga certifikata e datës 10.11.2005, Gjykata konstatoi se Ankuesi është regjistruar në NSH nga data 01.02.1988 deri më 30.11.1999. Libreza e punës i është mbyllur më 31.10.1990, në datën e njëjtë kur janë mbyllur edhe librezat e punës të 10 ankuesve tjerë. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi [REDAKTUE] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Ankuesi ka punuar për 2 vjet e 6 muaj për NSH-në sipas librezës së punës dhe marrëdhënia e punës i ka mbaruar për shkak të diskriminimit në vitin 1990. Ai u kthye në punë në vitin 1999 sipas certifikatës dhe se nuk ka dëshmi në lidhje me mënyrën se si i përfundoi marrëdhënia e punës. Por, pasi që ndaj Ankuesit është ushtruar diskriminim në vitin 1999 dhe punëtorët me të njëjtën gjendje (dhe me periudhë tre vjeçare të regjistruar) janë pranuar si me të drejta legitime, Gjykata ka vendosur mbi parimin e barazisë se ky Ankues duhet të pranohet gjithashtu. Ideja e nenit 10.4 është që t'u japë pjesë atyre që kontribuuuan për aktivitetet e NSH-së dhe atyre të cilët janë të regjistruar në kohën e privatizimit (mbyllijs së NSH-së në këtë rast). Por, punëtorët e diskriminuar nuk e kanë obligim ta vërtetojnë se ishin të regjistruar ashtu (në datën) dhe të punësuar (për 3 vjet).

Ankuesi C2/7 [REDAKTUE], i lindur më 20 maj 1958, ishte i punësuar në NSH nga 18 prilli 1986 deri më 31 maj 1990. Në seancës e shqyrtimit të provave, paditësi pohoi se ai ishte larguar prej pune nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. E Paditura nuk kundërshtoi se paditësi ishte i punësuar në NSH para datës 31 maj 1990. E Paditura nuk e kundërshtoi deklaratën e paditësit për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të Paditurës se ankesa është e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, më 21 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e cekura më lartë. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi [REDAKTUE] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e pagave për më shumë se tri vjet dhe se ai do të mund të ishte në listën e pagave më 1 qershor 2003, nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesi C2/8 [REDAKTUE], i lindur më 10 nëntor 1941, ishte i punësuar në NSH nga data 13 maj 1974 deri më 31 maj 1990. Në seancën e shqyrtimit të provave, ankuesi pohoi se ishte larguar prej pune nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi ishte i punësuar në NSH para datës 31 maj 1990, por argumentoi se ai e ka arritur moshën e pensionimit para datës 21 nëntor 2006. E Paditura nuk e kundërshtoi deklaratën e paditësit për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të Paditurës se padia është e pabazuar sepse ai nuk ishte i regjistruar në NSH në momentin e privatizimit, më 1 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e cekura më lartë. Dhoma e Posacme konstaton se ankuesi nuk e ka arritur moshën e pensionimit para 1 qershorit 2003. Prandaj, Ankuesi [REDAKTUE] i plotëson kërkesat ligjore nga nenii 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e pagave për më shumë se tri vite dhe se do të mund të ishte në listën e pagave më datën 1 qershor 2003, nëse nuk do të ishte diskriminuar. Në bazë të raportit nga kompania Tullorja, në lidhje me muajin tetor 2002, për kalkulimin e orëve të punës për IMN Tulloria, ankuesi radhitet nën numrin 15– faqja me numër 114 në mesin e dokumenteve të dorëzuara nga ky ankues C2/1). Në bazë të fletë pagesës për të ardhurat personale të muajit tetor 2002, ai ishte i punësuar në NSH në atë kohë, dhe nuk ka dëshmi se është lëshuar aktvendim për ndërprenjen e marrëdhënieve së punës deri në muajin qershor 2003.

Ankuesi C2/9 [REDACTED], i lindur më 5 nëntor 1946, ishte i punësuar në NSH nga 4 maji 1979 deri më 31 maj 1990. Në seancën e shqyrtimit të provave, ankuesi pohoi se është larguar prej pune nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH para datës 31 maj 1990. E paditura nuk e kundërshtoi deklaratën për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të paditurës se ankesa është e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, më 21 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e cekura më lartë. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e pagave për më shumë se tre vjet dhe se ai do të mund të ishte në listën e pagave më 1 qershor 2003, nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesi C2/10 [REDACTED], i lindur më 4 gusht 1949, ishte i punësuar në NSH nga 24 prilli 1971 deri më 31 maj 1990. Në seancën e shqyrtimit të provave, paditësi pohoi se është larguar prej pune nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. Ai filloi të punoj privatish si taksist në vitin 1992. E Paditura nuk kundërshtoi se paditësi ishte i punësuar në NSH para datës 31 maj 1990. E Paditura pohoi se ai nuk k atë drejta legjitime sepse filloi të punojë për një kompani tjeter nga 9 janari 1992 deri më 31 maj 1992. Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkesa ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në lisën e pagave për më shumë se tre vjet dhe ai do të mund të ishte në listën e pagave më 1 qershor 2003, nëse nuk do të ishte diskriminuar. Periudha e përmendur në librezën e tij të punës si periudhë që ka punuar për një punëdhënës tjeter nuk paraqet pengesa për konkludimin e pohuar. Në vitin 1992, NSH-ja nuk funksiononte, prandaj nuk ka konflikt në situatën e ankuesit – për kohën: qershor 2003 – dhe për të drejtat që ai i kërkon.

Ankuesi C2/11 [REDACTED], i lindur më 8 maj 1943, ishte i punësuar në NSH nga data 24 qershor 1972 deri më 31 maj 1990. Në seancën e shqyrtimit të provave, paditësi pohoi se ai ishte larguar prej pune nga regjimi serb për shkak të diskriminimit. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi ishte i punësuar në NSH para datës 31 maj 1990. E Paditura nuk e kundërshtoi deklaratën për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të Paditurës se ankesa është e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, më 21 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e cekura më lartë. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e pagave për më shumë se tre vjet dhe ai do të mund të ishte në listën e pagave më 1 qershor 2003, nëse nuk do të ishte i diskriminuar. Në bazë të raportit nga kompania Tullorja, për muajin tetor 2002, për kalkulimin e orëve të punës për IMN Tullorja, ankuesi radhitet nën numrin 30 (faqja me numër 114 në mesin e dokumenteve të dorëzuara nga ankuesi C2/1). Në bazë të atij dokumenti, ai ishte i punësuar nga NSH-ja në atë kohë, dhe se nuk ka dëshmi se është lëshuar aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës deri në muajin qershor 2003.

Ankuesi C2/12 [REDACTED], i lindur më 17 prill 1940, u punësua në NSH nga 6 nëntori 1965 deri më 31 maj 1990. Ankuesi pohoi se ai është larguar nga puna nga autoritetet serbe në vitin 1990. E Paditura nuk kundërshtoi se ankuesi është punësuar

në NSH para vitit 31 maj 1990, por argumentoi se ai e ka arritur moshën e pensionimit para datës 21 nëntor 2006. E Paditura nuk e kundërshtoi deklaratën për diskriminim në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Argumenti i të Paditurës se ankesa është e pabazuar sepse ai nuk është regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, më 21 nëntor 2006, nuk mund të pranohet për arsyet e përmendura më lartë. Dhoma e Posaçme konstaton se ankuesi nuk e ka arritur moshën e pensionimit më 1 qershor 2003. Prandaj, Ankuesi [REDACTED] i plotëson kërkuesat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai ka qenë në listën e pagave më 1 qershor 2003 nëse ndaj tij nuk do të ishte ushtruar diskriminim. Në seancën dëgjimore të caktuar, gjykata është informuar se ky ankues kishte ndërruar jetë. Një urdhër i është dërguar në adresën e tij për sqarime. Urdhri është pranuar, por nuk është dorëzuar ndonjë përgjigje. Pasi që nuk ka dëshmi për vdekjen e ankuesit, do të vendoset për meritat e padisë.

Sa i përket katër personave në listë, të kontestuar nga ankuesit tjera, duke i marrë parasysh librezat e punës së tyre, Dhoma e Posaçme konstatoi se nuk k arsyet përjashtohen ata. Për më tepër, tre nga ata ([REDACTED] dhe [REDACTED]) përmenden në raport nga kompania Silkapor, në lidhje me periudhën 2003 gjatë kalkulimit të orëve të punës për IMN Tulloria, me numër 1-3 dhe [REDACTED] përmendet në listat që korrespondojnë me vitin 2002 (me numër 17) dhe nuk janë aktvendime për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Nga këto dokumente, Gjykata konstatoi se ata i kanë drejtat e njëjta me punëtorët të cilët ishin të punësuar për tri vjet dhe ende kanë pasur marrëdhënie pune me NSH-në deri në qershor 2003.

Në pajtim me Rregullat Plotësuese Procedurale të Dhomës së Posaçme në lidhje me taksat gjyqësore në fuqi prej datës 10 mars 2010 (në bazë të nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) procedura në lëndët në lidhje me Listën e Punëtorëve me të Drejta Legitime (Neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6) është pa pagesë. Prandaj, nuk duhej të merrej vendim për taksat gjyqësore.

Prandaj, Dhoma e Posaçme vendos si në dispozitiv.

#### Këshillë Ligjore

Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktvendimi mund t'i ushtrohet me shkrim Kolegji të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi.

Piero Leanza, Gjyqtar Kryesues, [nënshkrimi]  
EULEX

Laura Plesa, Gjyqtare, [nënshkrimi]  
EULEX

Ilmi Bajrami, Gjyqtar [nënshkrimi]

Tobias Lapke, [nënshkrimi]  
Regjistrues, EULEX